

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/Departamenti i Përgjithshëm-Penal, Gjyqtari, Kujtim Krasniqi, me Zyrtaren Ligjore Dafina Ymeri, në çështjen penale kundër të A.Z.nga fshati S., Komuna e P., për shkak të veprës penale Ngacmim nga neni 186 par.1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr. 1458/13, të datës 04.04.2013, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datën 27.07.2018, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Rexhep Maqedonci, të akuzuarit Armend Zeqiri, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari: A.Z., nga i ati H.1, dhe e ëma H.2, e gjinisë B., i lindur më dt:... në fshatin S., Komuna e P., me numër personal ..., i gjendjes së mesme ekonomike, ka të kryer shkollën e mesme, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse, Me sjellje të vazhdueshme, të padëshirueshme, ka komunikuar, me qëllim të ngacmimit dhe të friksmit të të dëmtuarës L.B., se do ta privon nga jeta, në atë mënyrë që për shkak të shkëputjes së lidhjes së tyre të dashurisë nga e dëmtuara, i pandehuri A.Z. kohë pas kohe i është kanosur përmes telefonit të tij me numër ..., duke e thirrur dhe shkruar SMS duke i thënë: se edhe në koft nevoja qaty para derës kam me ardh me dhon shpirt e pa t'bo me fol vet me veti skam mi than vetit njeri, si dhe me datë.26.02.2013, rreth orës 20:00, në P.2, në lagjen "U.", te hyrja e konvikteve të studentëve, derisa e dëmtuara ishte duke hyrë brenda rrethojës së oborrit të konvikteve i pandehuri A.Z. i ka dal para , eka kapur për dore duke e shtrenguar dhe i ka thënë: ti sot ke me ardhur me mua, ku unë të dërgoj, ku dua unë vet, pastaj e dëmtuara e ka kundërshtuar dhe është larguar,-

-me këtë ka kryer veprën penale Ngacmimi nga neni 186 par.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata konform nenit 4, 7, 41, 46 dhe 73 të KPRK-së si dhe nenit 248 dhe 365 të KPRK-së, të njëjtit i shqipton:

D Ë N I M M E G J O B Ë

Në shumën prej **300 (treqind) euro**, te cilin është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi.

Dënimin e shqiptuar i pandehuri mundë ta paguajë deri në 3 (tre) këste mujore në afat kohor prej 3 (tre) muaj, ederi në datën 5 të muajit vijues nga dita e marrjes së formës së prerë e këtij aktgjykimi.

Në rast se i pandehuri nuk e paguan dënimin e shqiptuar, gjykata mundësinë e pagesës me këste do ta revokoj dhe konform nenit 46 të KPRK-së i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgimi **duke llogaritur çdo 20 (njëzet) euro me 1 (një) ditë burg.**

Obligoheti akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 25 (njëzet e pesë) euro, në afat prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

E dëmtuara: dëshmitarja- L.B. nga fshati M. Komuna e P.1, lidhur me realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë- Departamenti i përgjithshëm ka paraqitur aktakuzën PP.II.nr. 1458/13, të datës 04.04.2013, kundër të akuzuarit A.Z. nga fshati S. Komuna, e P.1, për shkak të veprës penale Ngacmimi nga neni 186 par.1 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale, gjykata ka caktuar dhe ka mbajtur shqyrtimin fillestar me datë 27.07.2018, ku pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i Shtetit, gjykata i ka mundësuar të pandehurit pranimin e fajësisë apo të deklarohet i pafajshëm.

Pasi që në fillim të shqyrtimit fillestar, i pandehuri në kuptim të nenit 248 të KPPRK-së, ka pranuar fajësinë për veprën penale Ngacmimi nga neni 186 par.1 të KPRK-së, gjykata në rastin konkret, pas marrjes së mendimit nga Prokurori i Shtetit, i cili është deklaruar që të aprovohet pranimi i fajësisë nga i pandehuri dhe pas vërtetimit se janë përmbushur kërkesat nga neni 248 par. 1, nën – par. 1.1, 1.2, dhe 1.3 të KPPRK-së, përkatësisht pas vlerësimit se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se ky pranim është bërë në baza vullnetare dhe se mbështetet në faktet dhe provat që përmban aktakuza, po ashtu pas vërtetimit se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike të paraparë me nenin 248 par. 1, nën – par. 4 të KPPRK-së, ka marr aktvendim me të cilin ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri lidhur me veprën penale e cila i vihet në barrë.

Pas pranimit të fajësisë dhe konstatimit të përmbushjes së kushteve në referim të nenit 248 par. 1, nën – par. 1.1, 1.2, dhe 1.3, të KPPRK-së, gjykata ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit, gjykata i vlerësoi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, të cilat konform nenit 73 dhe 74 të KPRK-së, ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit e të cilat janë me ndikim me rastin e dënimit, ashtu që për të akuzuarin A.Z., si rrethana lehtësuese gjeti se: i pandehuri e pranoi fajësinë për veprën penale, se ishte korrekt dhe me sjellje korrekte në gjykatë, ka shpreh keqardhje mbi faktin se nuk do ta përsëris asnjëherë një veprim të tillë, ndërsa rrethana rënduese nuk gjeti, dhe nisur nga të gjitha këto të thëna gjykata i shqiptoi dënim me kusht me bindje se në rastin konkret është adekuat me shkallën e përgjegjësisë penale të të pandehurit dhe se me dënim me kusht do të arrihet qëllimi i dënimit, i paraparë me nenin 50 të KPRK-së.

Në rastin konkret gjykata vlerësoi se dënimi me kushti shqiptuar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesit sipas nenit 73.par.2 të KPRK-së, me shkallën dhe përgjegjësinë e kryesit, me bindje se dënimi i tillë do të ndikoj në risocializimin dhe riedukimin e kryesit, si dhe do të ndikoj te të tjerët të mos kryejnë vepra penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i dënimit sipas nenit 41 të KPRK-së.

E dëmtuara, për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.

Mbi bazën e të dhënave si më lart, në bazë të nenit 248 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm-Penal
P.nr.1527/2013, dt.27.07.2018

Zyrtare Ligjore
Dafina Ymeri

Gjyqtari

Kujtim Krasniqi

UDHËZIMI JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit të Kosovës.